



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria Rajonale Tiranë



Rruga: "Himkoll", Tiranë. Tel: +35542228896. E-mail: juridikutirane@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksksh.com.al

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë shpall vend të lirë pune për:

1 (një) Specialist Farmacist në Sektorin e Rimbursimit pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetsore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për krime dhe të mos ketë process në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më pare nga administrata e FSDKSH apo shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Farmacisë;
- Të jetë i pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit;
- Të ketë njohuri në përdorimin e kompjuterit;
- Zotërimi i gjuhës së huaj përbën avantazh (preferohet Anglisht);
- Të ketë aftësi menaxhuese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë, **brenda datës 02 Shkurt 2017**, si më poshtë vijon:

- Kërkesë për punësim;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae);
- Diplomë e noterizuar;
- Diplomë Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Çertifikatë kompjuteri;
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;

- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar (sipas rastit);
- Librezën e punës;
- Fotokopje e kartës së indentitetit;
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Çertifikatë Familiare;
- Raport mjekësor për aftësi në punë;
- Liçensën e ushtrimit të profesionit e noterizuar;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentacioni dorëzohet në zarf të mbyllur i cili protokollohet.

Adresa:

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Rruga: “Himkollli”, Tiranë. Tel: +35542228896. E-mail: juridikutirane@fsdksh.com.al.